



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 640/1 prot.

Tiranë, më 21.07.2020

VENDIM
Nr.76, datë 21.07.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 128, DATË 11.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA CËRRIK

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 128, datë 11.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Cërrik, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Cërrik.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Cërrik, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 128, datë 11.11.2019, duke i

lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 2 (dy) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Cërrik, me shkresën nr.3992/2 prot., datë 11.12.2019, *“Informacion mbi rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil bazuar në Vendimin Nr. 128, datë 11.11.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur një pjesë të dokumentacionit që provon zbatimin e tij.

Gjithashtu, njësia përgjegjëse, në rrugë elektronike, në datën 15.7.2020, ka dërguar pjesën e dokumentacionit që mungonte në shkresën e sipërpërmendur dhe që vërteton zbatimin e plotë të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Cërrik, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit rezulton se, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit, duke ndërprerë marrëdhënien e punësimit në kundërshtim me ligjin, për punonjësit: *****, *****, ***** dhe *****.
2. Bashkia Cërrik në bazë të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, ka vijuar dhe po vijon procedurat e konkurrimit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 128, datë 11.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Cërrik, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në*

strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Cërrik.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Cërrik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha